

20261552239

## МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 25, paragrafit (3) të Ligjit për Standardin e Studentëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 15/13, 120/13, 41/14, 146/15, 30/16, 178/16, 64/18 dhe 20/19, si dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 124/19, 248/20, 302/20, 235/24 dhe 111/26), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

### **R R E G U L L O R E** **PËR MËNYRËN E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË KONVIKTET SHTETËRORE** **TË STUDENTËVE**

#### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e pranimi të studentëve në konvikte shtetërore të studentëve.

#### Neni 2

Për pranim në konvikte shtetërore të studentëve (në tekstin e mëtejshëm: konvikte), mund të aplikojnë studentët e rregullt të regjistruar në studimet deridiplomike të ciklit të parë në universitetet publike dhe private, si dhe në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilët studiojnë jashtë vendbanimit të tyre, edhe atë:

- studentë të rregullt të regjistruar për herë të parë në studimet deridiplomike të ciklit të parë;
- studentë të rregullt të regjistruar në fakultete me më pak se tetë semestra, të cilët nuk kanë përsëritur asnjë vit studimor;
- studentë të rregullt të regjistruar në fakultete me tetë semestra, të cilët nuk kanë përsëritur më shumë se një vit studimor;
- studentë të rregullt të regjistruar në fakultete me më shumë se tetë semestra, të cilët nuk kanë përsëritur më shumë se dy vite studimore.

#### Neni 3

Studentët e regjistruar për herë të dytë si absolventë nuk kanë të drejtë të aplikojnë në Konkursin për pranimin e studentëve në konvikte (në tekstin e mëtejshëm: Konkursi).

#### Neni 4

Studentët të cilët kanë shkelur rregulloren e rendit shtëpiak në konvikt dhe ndaj të cilëve është shqiptuar masa edukative e ndalimit të shfrytëzimit të shërbimeve të konviktit, për periudhën e përcaktuar në masën e shqiptuar edukative, nuk aplikojnë në Konkurs në asnjërin prej konvikteve.

Studentët të cilët nuk i kanë shlyer detyrimet financiare për akomodimin ndaj konvikteve për më shumë se një muaj, nuk aplikojnë në Konkurs në asnjërin prej konvikteve.

#### Neni 5

Studentët nga neni 2 i kësaj rregulloreje plotësojnë aplikimin elektronik dhe bashkëngjisin dokumentacionin e nevojshëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Konkurs.

#### Neni 6

Pranimi i studentëve në konvikte bëhet në bazë të:

- suksesit në mësimе, përkatësisht suksesit të arritur gjatë studimeve;
- gjendjes familjare dhe materiale të studentit; dhe
- Vijueshmëria e studentit në studime për studentët e vitit të dytë dhe të viteve vijuese të studimit.

#### Neni 7

Shpërndarja e numrit të përgjithshëm të vendeve të disponueshme në konvikte për studentët e përmendur në nenin 5 të kësaj rregulloreje bëhet në përputhje me nenin 25, paragrafin (1) të Ligjit për Standardin e Studentëve edhe atë:

a) Grupi i parë – 40% e numrit të përgjithshëm të vendeve të disponueshme në konvikte u dedikohen studentëve, të ardhurat totale për anëtar të familjes të të cilëve janë deri në shumën e pagës minimale neto të përcaktuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, edhe atë:

- studentë, fëmijë pa prindër dhe pa kujdes prindëror;
- studentë, fëmijë me nevoja të veçanta,
- studentë, fëmijë të përfituesve të ndihmës minimale të garantuar,
- studentë, fëmijë me prind vetëushqyes;
- studentë, fëmijë të prindërve të papunë dhe
- studentë, fëmijë të përfituesve të kompensimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës për arsye biznesore.

b) Në grupin e parë përfshihen edhe studentët, fëmijë me prind vetëushqyes, studentët, fëmijë të prindërve të papunë, studentët, fëmijë pa prindër dhe pa kujdes prindëror, studentët, fëmijë me nevoja të veçanta, si dhe studentët, fëmijë të përfituesve të kompensimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës për arsye afariste, për të cilët të ardhurat totale për anëtar të familjes janë mbi pagën minimale neto të përcaktuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

c) Grupi i dytë - 25% e numrit të përgjithshëm të vendeve të disponueshme në konvikte u dedikohen studentëve që kanë arritur sukses veçanërisht të lartë në mësimе.

ç) Grupi i tretë - 35% e numrit të përgjithshëm të vendeve të disponueshme në konvikte u dedikohen studentëve të rregullt të regjistruar në ciklin e parë të studimeve në universitetet publike dhe private, si dhe në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilët nuk bëjnë pjesë në grupet e pikave a), b) dhe c) të këtij neni.

#### Neni 8

Nga numri i përgjithshëm i vendeve të disponueshme në konvikte nga neni 7 i kësaj rregulloreje, 20% u dedikohen studentëve të rregullt që për herë të parë do të regjistrohen në ciklin e parë të studimeve në universitetet publike dhe private, si dhe në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 9

Renditja e studentëve nga neni 7, pika a) e kësaj rregulloreje bëhet në mënyrën e mëposhtme:

- studentët mund të marrin deri në 100 pikë, ku deri në 70 pikë merren për suksesin e arritur gjatë studimeve dhe deri në 30 pikë për kohëzgjatjen e përfitimit të ndihmës minimale të garantuar, ndërsa fëmijët pa prindër dhe pa kujdes prindëror si dhe fëmijët me nevoja të veçanta, për të cilët të ardhurat totale për anëtar të familjes janë deri në pagën minimale neto të përcaktuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, fitojnë maksimumin prej 100 pikë.

Në bazë të suksesit të arritur gjatë studimeve, pikët fitohen sipas formulës së mëposhtme:

Maksimumi i pikëve nga sukseси i arritur = Sukseси mesatar  $\times$  7.

Për studentët nga neni 8 i kësaj rregulloreje, në bazë të suksesit nga diploma e përfundimit të arsimit të mesëm, pikët fitohen sipas formulës së mëposhtme: Maksimumi i pikëve nga sukseesi i arritur = Sukseesi mesatar  $\times$  14.

Në bazë të kohëzgjatjes së përfitimit të ndihmës minimale të garantuar, pikët fitohen në mënyrën e mëposhtme:

| Kohëzgjatja e përfitimit të ndihmës minimale të garantuar | Pikë |
|-----------------------------------------------------------|------|
| deri në 1 vit                                             | 10   |
| nga 1 deri në 3 vjet                                      | 20   |
| mbi 3 vjet                                                | 30   |

#### Neni 10

Renditja e studentëve nga neni 7, pika b) e kësaj rregulloreje bëhet në mënyrën e mëposhtme:

- studentët mund të marrin deri në 100 pikë, ku deri në 50 pikë fitojnë për gjendjen familjare dhe materiale, dhe deri në 50 pikë për suksesin e arritur në mësim, përkatësisht suksesin e arritur gjatë studimeve, ndërsa fëmijët pa prindër dhe pa kujdes prindëror si dhe fëmijët me nevoja të veçanta, për të cilët të ardhurat totale në familje mund të jenë edhe mbi pagën minimale neto të përcaktuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, fitojnë maksimumin prej 100 pikësh.

Në bazë të gjendjes familjare dhe materiale të studentit dhe familjes së tij të ngushtë, merren parasysh të ardhurat totale mujore për anëtar të familjes së studentit (pagat mujore neto, pensionet dhe të ardhurat vjetore nga baza të ndryshme, të paraqitura në formularin e Ministrisë së Financave – Drejtorisa e të Ardhurave Publike - veprimtari bujqësore, veprimtari ekonomike, të drejta autoriale, dhënie me qira e hapësirave dhe të ardhura të tjera) në raport me pagën mesatare mujore neto të paguar për punonjës në Republikën e Maqedonisë së Veriut për tre muajt e fundit, të përcaktuar nga Enti Shtetëror i Statistikës. Nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të ulëta ose të barabarta me 35% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati merr numrin maksimal të pikëve, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të larta se 35%, por më të vogla ose të barabarta me 45% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati merr 40 pikë, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të larta se 45%, por më të ulëta ose të barabarta me 55% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati merr 30 pikë, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të mëdha se 55%, por më të ulëta ose të barabarta me 65% të pagës mesatare mujore neto të paguar në republikën e maqedonisë së Veriut kandidati fiton 20 pikë, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të larta se 65%, por më të ulëta ose të barabarta me 75% të pagës mesatare mujore të paguar në neto në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati merr 10 pikë, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të mëdha se 75% e pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk fitohen pikë.

Në bazë të gjendjes familjare dhe materiale të studentit, pikët fitohen në mënyrën e vazhdim:

| Gjendja familjare dhe materiale e studentit | Pikë |
|---------------------------------------------|------|
| deri në 35%                                 | 50   |
| nga 35% deri në 45%                         | 40   |

|                     |    |
|---------------------|----|
| nga 45% deri në 55% | 30 |
| nga 55% deri në 65% | 20 |
| nga 65% deri në 75% | 10 |
| mbi 75%             | 0  |

Në bazë të suksesit të arritur gjatë studimeve, pikët fitohen sipas formulës së mëposhtme:

Pikët maksimale nga suksezi i arritur = Suksezi mesatar  $\times$  5.

Për studentët nga neni 8 i kësaj rregulloreje, në bazë të suksesit nga diploma e përfundimit të arsimit të mesëm, pikët fitohen sipas formulës së mëposhtme:

Pikët maksimale nga suksezi i arritur = Suksezi mesatar  $\times$  10.

#### Neni 11

Studentët nga neni 7 pika c) e kësaj rregulloreje, të cilët kanë arritur sukses veçanërisht të lartë në mësim, fitojnë deri në 100 pikë për suksesin e arritur gjatë studimeve.

Në bazë të suksesit të arritur gjatë studimeve, pikët fitohen sipas formulës së mëposhtme:

Pikët maksimale nga suksezi i arritur = Suksezi mesatar  $\times$  10.

Për studentët nga neni 8 i këtij rregulloreje, në bazë të suksesit nga diploma e përfundimit të arsimit të mesëm, pikët fitohen sipas formulës së mëposhtme:

Pikët maksimale nga suksezi i arritur = Suksezi mesatar  $\times$  20.

#### Neni 12

Studentët nga neni 7 pika ç) e kësaj rregulloreje fitojnë deri në 100 pikë, ku nga numri i përgjithshëm i pikëve, deri në 40 pikë fitohen për suksesin e arritur gjatë studimeve, deri në 10 pikë fitohen në bazë të vijueshmërisë së studimeve dhe deri në 50 pikë jepen në bazë të gjendjes familjare dhe materiale të studentit.

Në bazë të suksesit të arritur gjatë studimeve, pikët fitohen sipas formulës në vazhdim: Pikët maksimale nga suksezi i arritur = Suksezi mesatar  $\times$  4.

Studentët nga neni 8 i kësaj rregulloreje fitojnë deri në 100 pikë, ku deri në 50 pikë fitohen për gjendjen familjare dhe materiale, ndërsa deri në 50 pikë fitohen në bazë të suksesit nga diploma e përfundimit të arsimit të mesëm.

Për studentët nga neni 8 i kësaj rregulloreje, në bazë të suksesit nga diploma e përfundimit të arsimit të mesëm, pikët fitohen sipas formulës në vazhdim:

Pikët maksimale nga suksezi i arritur = Suksezi mesatar  $\times$  10.

- Në bazë të vijueshmërisë së studimeve mund të fitohen deri në 10 pikë, edhe atë:

studentët që i kanë përfunduar rregullisht vitet e mëparshme të studimeve, pa përsëritur vit akademik, fitojnë deri në 10 pikë;

-studentët që kanë përsëritur vit akademik dhe absolventët për herë të parë nuk marrin pikë.

Në bazë të gjendjes familjare dhe materiale të studentit dhe familjes së tij të ngushtë, merren në konsideratë të ardhurat totale mujore për anëtar të familjes së studentit (pagat neto mujore, pensionet dhe të ardhurat vjetore nga baza të ndryshme të paraqitura në formularin e Ministrisë së Financave-Drejtoria e të Ardhurave Publike: veprimtari bujqësore, veprimtari ekonomike, të drejta autoriale, dhënie me qira të hapësirave dhe të ardhura të tjera), në raport me pagën mesatare mujore neto të paguar për punonjës në Republikën e Maqedonisë së Veriut për tre muajt e fundit, të përcaktuar nga Enti Shtetëror i Statistikës. Nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të ulëta ose të barabarta me 35% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati fiton numrin maksimal të pikëve, nëse të ardhurat

mujore të familjes për anëtar janë më të larta se 35%, por më të ulëta ose të barabarta me 45% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati fiton 40 pikë, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të larta se 45%, por më të ulëta ose të barabarta me 55% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati fiton 30 pikë, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të larta se 55%, por më të ulëta ose të barabarta me 65% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati fiton 20 pikë, nëse të ardhurat mujore të familjes për anëtar janë më të larta se 65%, por më të ulëta ose të barabarta me 75% të pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kandidati fiton 10 pikë, për të ardhurat mujore të familjes për anëtar që janë më të larta se 75% e pagës mesatare mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nuk jepen pikë.

Në bazë të gjendjes familjare dhe materiale të studentit, pikët jepen në mënyrën në vazhdim:

| Gjendja familjare dhe materiale e studentit  | Pikë |
|----------------------------------------------|------|
| <input type="checkbox"/> deri në 35%         | 50   |
| <input type="checkbox"/> nga 35% deri në 45% | 40   |
| <input type="checkbox"/> nga 45% deri në 55% | 30   |
| <input type="checkbox"/> nga 55% deri në 65% | 20   |
| <input type="checkbox"/> nga 65% deri në 75% | 10   |
| <input type="checkbox"/> mbi 75%             | 0    |

#### Neni 13

Lista e studentëve me pikët e fituara publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe në faqen e internetit të konvikteve.

#### Neni 14

Nga persona të caktuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës:

- shqyrtohet dokumentacioni i bashkëngjitur nga neni 5 i kësaj rregulloreje;
- përpilohet lista e studentëve të pranuar sipas konvikteve dhe e njëjta publikohet në përputhje me nenin 13 të kësaj rregulloreje dhe
- vendoset për kundërshtesat e studentëve.

#### Neni 15

Studenti i pranuar për akomodim dhe ushqim në një nga konviktet nuk mund t'ia transferojë vendin një student tjetër.

#### Neni 16

Vendi i studentit që është pranuar për akomodim dhe ushqim në një nga konviktet, por që nuk vendoset brenda afatit të përcaktuar me Konkursin, plotësohet sipas radhës nga lista përfundimtare e studentëve të pranuar sipas konvikteve.

#### Neni 17

Nëse në konvikte mbeten vende të paplotësuara, ato mund të plotësohen me studentë që nuk i plotësojnë kushtet sipas këtij rregulloreje ose me nxënës të regjistruar si nxënës të rregullt në arsimin e mesëm.

Studentët nga paragrafi 1 i këtij neni paguajnë çmimin e plotë ekonomik për akomodim dhe ushqim.

Gjatë pranimi të nxënësve nga paragrafi 1 i këtij neni, zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat e Rregullores për mënyrën dhe procedurën e pranimi të nxënësve në konviktet publike të nxënësve.

#### Neni 18

Me hyrjen në fuqi të këtij rregulloreje, pushon së vlejti Rregullorja për mënyrën e pranimi të studentëve në konviktet shtetërore studentore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 89/13, 98/13 dhe 130/16).

#### Neni 19

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën pas shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 19-9100/2  
8.7.2025  
Shkup

Ministre e Arsimit  
dhe Shkencës,  
Pr. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.